



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1345/7 prot.

Datë 25.07.2022

V E N D I M

Nr. 710/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF- 27343-05-04-2022, me objekt: “Blerje kanceleri dhe tonera”, me fond limit 6.638.300 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK
Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8.Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës
Sheshi “Liria”, Durrës.

Subjekte të Interesuar: “Erison Kompani” SHPK
L.6, Rr. “Shoqëria Bashkimi”, P.CGAS, Kati 1, Durrës

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për

organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.05.2022, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF- 27343-05-04-2022, me objekt: “Blerje kanceleri dhe tonera”, me fond limit 6.638.300 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 06.06.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si vijon:

“Infosoft Office” SHPK	2.876.155 lekë, skualifikuar
“Erison Kompani” SHPK	3.619.842 lekë, kualifikuar

“Adenis Kastrati” SHPK	3.782.980 lekë, kualifikuar
“Ervin Luzi” SHPK	4.048.900 lekë, kualifikuar
“Librari Dyrrahu” SHPK	4.074.070 lekë, kualifikuar
“Marketing & Distribution” SHPK	4.413.632 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK është skualifikuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me argumentin si vijon:

- *Operatori ekonomik InfoSoft Office me oferte anomalisht te ulet (56.67%) te fondit limit, me vlere 2.876.155 lekë, pas kerkeses se KVO ne date 23.05.2022 per argumentimin dhe shpjegimin e ofertes anomalisht te ulet, ne baze te afatit ligjor 3 dite pune per paraqitjen e dokumentacionit argumentues nga operatori ekonomik. Operatori ekonomik ka kthyer pergjigje ne date 27.05.2022 pasi data 25.05.2022 ne qarkun e Tiranes ka gene dite pushimi zyrtare. KVO vlereson si me poshte:*

- *Faturat e blerjes te paraqitura nga operatori ekonomik nuk jane ne gjuhen e ofertes, gje e cila bie ndesh me kerkesat ne DST. (Shtojca 7, Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.) duke e bere te pa mundur analizimin e detajuar te ofertes.*

- *Operatori ka paraqitur Fature Tatimore Shitje te vitit 2018. Artikujt ne keto fatura tatimore shitje kane te njejten cmim ose dhe me te larte se cmimet e paraqitura ne preventiv. Periudha nga viti 2018 deri ne Prill te vitit 2022 ka pesuar nje rritje te normes se inflacionit me 5.5%. Burimi Banka e Shqiperise.*

(https://ëëë.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Objektivi_dhe_strategjia/Inflacioni_baze.html)

KVO nuk pranon te vlefshme shpjegimin e ofertes per anomalisht te ulet. (bashkengjitur materiali i ofertuesit derguar AK, ne forme elektronike ne SPE. KVO vendos qe ofertuesi InfoSoft Office të mos kualifikohet.

II.3. Në datën 20.06.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit për procedurën e prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve.

II.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 24.06.2022, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik është administruar ankesa me nr. 1345/2022 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2302 e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK. Në ankesë ngrihen pretendime për skualifikimin e padrejtë të operatorin ekonomik ankimues, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1345/2 datë 24.06.2022, me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK.

II.6. Në datën 05.07.2022, nëpërmjet shkresës nr. 1345/3 prot., me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK”, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së, në përputhje me

nenin 114 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të dërgojë pranë këtij Komisioni, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e shkresës në fjalë, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, argumentat përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga shoqëria “Infosoft Office” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 2885/10 prot, datë 08.07.2022 me objekt: “*Dërgim informacioni për shkresën nr. 1345/3 prot., dt 05.07.2022*”, protokolluar me tonën me nr. 1345/5 prot, datë 12.07.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni mbi procedurën e prokurimit si dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit e ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik..

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK, me arsyetimin se “- *Operatori ekonomik InfoSoft Office me oferte anomalisht te ulet (56.67%) te fondit limit, me vlere 2.876.155 lekë, pas kerkeses se KVO ne date 23.05.2022 per argumentimin dhe shpjegimin e ofertes anomalisht te ulet, ne baze te afatit ligjor 3 dite pune per paraqitjen e dokumentacionit argumentues nga operatori ekonomik. Operatori ekonomik ka kthyer pergjigje ne date 27.05.2022 pasi data 25.05.2022 ne qarkun e Tiranës ka qene dite pushimi zyrtare. KVO vlereson si me poshte:*

- *Faturat e blerjes te paraqitura nga operatori ekonomik nuk jane ne gjuhen e ofertes, gje e cila bie ndesh me kerkesat ne DST. (Shtojca 7, Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.) duke e bere te pa mundur analizimin e detajuar te ofertes.*

- *Operatori ka paraqitur Fature Tatimore Shitje te vitit 2018. Artikujt ne keto fatura tatimore shitje kane te njejten cmim ose dhe me te larte se cmimet e paraqitura ne preventiv. Periudha nga viti 2018 deri ne Prill te vitit 2022 ka pesuar nje rritje te normes se inflacionit me 5.5%. Burimi Banka e Shqiperise.*

https://ëëë.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Objektivi_dhe_strategjia/Inflacioni_baze.html).

KVO nuk pranon te vlefshme shpjegimin e ofertes per anomalisht te ulet. (bashkengjitur materiali i ofertuesit derguar AK, ne forme elektronike ne SPE. KVO vendos qe ofertuesi InfoSoft Office te mos kualifikohet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën protokolluar me tonën me nr. nr. 1345/5 prot, datë 12.07.2022, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e shoqërisë “InfoSoft Office” SHPK është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte në datën 23.05.2022 KVO i është drejtuar operatorit ekonomik me kërkesë për sqarim/ argumentim oferte anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së si më poshtë vijon:

Shpjegim për ofertë anomalisht të ulët për proçedurën e prokurimit me objekt: “Blerje kancelarie dhe tonera”

*Për sa më sipër, në përputhje me nenin 93 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe DT, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi t’i kërkojë shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë, ofertuesit **InfoSoft Offive sh.p.k me Nipt J62426002Q** me vlerë të ofertës **2’876’154.74 lekë**.*

Ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së, brenda tri ditëve pune, shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;*
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;*
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

III.1.2. Në përgjigje të kërkesës së KVO, më datë 27.05.2022 operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka paraqitur në mënyrë shkresore dokumentacionin si më poshtë:

1. Shkresë datë 27.05.2022, me objekt: “Sqarim për ofertën anomalisht të ulët”. Në këtë shkresë, thuhet se:

“[...]Morem permes faqes se APP nje kerkese nga ana juaj, permes te ciles na kerkohej argumentim i ofertes anomalisht te ulet, te paraqitur nga Infosoft Office sh.p.k. ne tenderin me objekt “Blerje kancelarie dhe tonera” te dates 23.05.2022. Per te sqaruar: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara Shpjegojme: Per tju sqaruar lidhur me anen ekonomike te kesaj oferte po ju paraqesim nje analize te detajuar te kostos, me perllogaritje per cdo artikull, dhe me te gjitha elementet perberese te cmimeve, mbeshtetur ne fatura blerje artikujsh, flete zhdoganime, oferta te marra nga furnitoret tane.

Per te sqaruar: b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; Shpjegojme:

Infosoft Office është kompani lider në tregun shqiptar për tregtimin e artikujve të kancelerisë, letres dhe tonerave, me një përvojë mbi 20 vjetë, me mundësi financiare të konsoliduara, me një xhiro vjetore për vitin 2019 prej 987,142,904 leke, për vitin 2020 prej 894,144,598 leke dhe për vitin 2021 979,602,980 leke .

Kompania jone është distributor i autorizuar për shumë marka produktesh. Kjo na jep mundësinë të përfitojmë çmime shumë favorizuese. Me synimin për të fituar këto tender, Infosoft Office ka ofertuar me një normë të ulët fitimi, gjë që shpjegon edhe vlerën e ulët të ofertës sone. Me çmime të ngjashme, të ofertuara në këto procedura prokurimi, Infosoft Office ka kuotuar, fituar dhe realizuar me sukses për 13 vjet prokurimet e përqendruara për tonera, leter dhe kancelari të zhvilluara nga Ministria e Brendshme (ku përfshihen të gjitha ministrat e vendit, Kryeministria, etj), si edhe një sërë tenderash të tjera të zhvilluar nga autoritete të tjera kontraktore: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimit të Proves, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Bashkia e Tiranës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Universiteti i Tiranës, Prokuroria e Përgjithshme, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme, Albcontrol, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Posta Shqiptare, Ujesjelles Kanalizime Tiranë, Ujesjelles Kanalizime Durrës, Agjencia e Trajtimin të Pronave, e shumë institucione të tjera.

Qindra kontratat e realizuara me sukses në shumë vite pune tregojnë qartë mundësinë e Infosoft Office sh.p.k. për të realizuar këto furnizime në kohë dhe cilësi, si edhe aftësinë për të ofruar zgjidhje teknike për furnizimin e mallrave në sasi të mëdha, në një kohë të shkurtër.

Bashkëgjatë gjeni edhe disa vërtetime realizimi kontratash dhe faktura të ngjashme, që tregojnë realizimin me sukses të tyre.

Sjellim në vëmendje që kompania jone ka fituar dhe realizuar me sukses këto tender në tre vitet e fundit (2018, 2019, 2020), pra e njohim me se miri specifikën e këtij tenderi dhe kërkesat e institucionit tuaj. Për të sqaruar: c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; Shpjegojmë: Konfirmojmë se artikujt e ofertuar nga kompania jone plotësojnë të gjitha specifikimet teknike të kërkuara nga ju në dokumentat e tenderit dhe të gjitha standartet ndërkombëtare të cilësive. Janë prodhuar sipas standarteve ndërkombëtare ISO 9001 për cilësinë, që do të thotë sipas standarteve më të larta të cilësive.

Përmes dokumentave të paraqitur në tender kemi marrë përsipër plotësimin e të gjitha specifikimeve të artikujve, gjë që e rikonfirmojmë edhe një herë. Gjithashtu kemi paraqitur në tender edhe dokument që ju keni parë të arsyeshme të kerkoni, për tu siguruar për cilësinë e produkteve. Tonerat e ofertuar janë origjinale ose ekuivalente, jo të rimbushur.

Tonerat janë të reja, të përdorura, të ambalazuara në kuti, . Tonerat plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë. Tonerat për printera dhe fotokopje plotësojnë sasitë e faqeve sipas datashet-in dhe katalogut perkates të pajisjeve (printera, fotokopje) . Tonerat inkjet kanë date skandence jo më pak se 1 vit nga data e Furnizimit të Mallit. Për të sqaruar: ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. Shpjegojmë: Për tju konfirmuar që kompania jone plotëson të gjitha detyrimet ligjore, po ju paraqesim një vërtetim të pagesës së rregullt të detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Kompania jone është e certifikuar sipas standarteve ndërkombëtare me ISO 9001 për Sistemin e Menaxhimit të Cilësive, BS PASS 99:2012 për Sistemin e Menaxhimit të Integruar, ISO 45001 për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Punë dhe ISO 14001 për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit në

vendet ku ushtrojme aktivitetin apo ofrojme shërbimet (bashkëgjatur). Ne përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, kërkojmë nga ju që të gjitha dokumentat shoqerues të permendura më lart, të administrohen si informacion konfidencial, të perdoren vetëm për qëllimin e kërkuar dhe të mos ju behen të ditura paleve të treta. Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetemi në dispozicionin tuaj për çdo sqarim të mëtejshëm dhe jemi të gatshëm të paraqesim çdo dokumentacion shtesë të nevojshëm.”

Bashkëgjatur shkresës së sipërcituar, operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK ka dorëzuar analizën e kostos, kontrata të lidhura me institucione shtetërore, fatura blerjesh, fletë zhdoganimi, fatura tatimore shitje si dhe oferta nga furnitorë.

III.1.3. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë. 2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore. 3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]”

III.1.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur; Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. - Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së. - Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.1.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, konstatohet, se oferta ekonomike në vlerën prej 2.876.155 lekë pa TVSh , në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet

të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis. Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj.

Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit

përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës 27.05.2022, me objekt: “*Sqarim për ofertën anomalisht të ulët*”, ku ka shpjeguar të gjitha elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë. Konkretisht ankimesi ka deklaruar se: “*...Infosoft Office është kompani lider në tregun shqiptar për tregtimin e artikujve të kancelerise, letres dhe tonerave, me një përvojë mbi 20 vjetecare, me mundësi financiare të konsoliduara, me një xhiro vjetore për, për vitin 2019 prej 987,142,904 leke, për vitin 2020 prej 894,144,598 leke dhe për vitin 2021 979,602,980 leke. Kompania jone është distributor i autorizuar për shumë marka produktesh. Kjo na jep mundësinë të përfitojmë çmime shumë favorizuese. Me synimin për të fituar këto tender, Infosoft Office ka ofertuar me një normë të ulët fitimi, gjë që shpjegon edhe vlerën e ulët të ofertës sone. Me çmime të ngjashme, të ofertuara në këto procedura prokurimi, Infosoft Office ka kuotuar, fituar dhe realizuar me sukses për 13 vjet prokurimet e përqendruara për toner, leter dhe kancelari të zhvilluara nga Ministria e Brendshme (ku përfshihen të gjitha ministrat e vendit, Kryeministria, etj), si edhe një sërë tenderash të tjera të zhvilluar nga autoritete të tjera kontraktore: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimit të Proves, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Bashkia Tirane, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Universiteti i Tiranës, Prokuroria e Përgjithshme, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme, Albcontrol, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Posta Shqiptare, Ujesjelles Kanalizime Tirane, Ujesjelles Kanalizime Durres, Agjencia e Trajtimit të Pronave, e shumë institucione të tjera. Qindra kontratat e realizuara me sukses në shumë vite pune tregojnë qartë mundësinë e Infosoft Office sh.p.k. për të realizuar këto furnizime në kohë dhe cilësi, si edhe aftësinë për të ofruar zgjidhje teknike për furnizimin e mallrave në sasi të mëdha, në një kohë të shkurtër. Bashkangjitur gjeni edhe disa vertetime realizimi kontratash dhe fatura të ngjashme, që tregojnë realizimin me sukses të tyre. Sjellim në vëmendje që kompania jone ka fituar dhe realizuar me sukses këto tender në tre vitet e fundit (2018, 2019, 2020), pra e njohim me se miri specifikën e këtij tenderi dhe kërkesat e institucionit tuaj. Për të sqaruar: c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; Shpjegojmë: Konfirmojmë se artikujt e ofertuar nga kompania jone plotësojnë të gjitha specifikimet teknike të kërkuara nga ju në dokumentat e tenderit dhe të gjitha standartet ndërkombetare të cilësive. Janë prodhuar sipas standarteve ndërkombetare ISO 9001 për cilësinë, që do të thote sipas standarteve me të larta të cilësive. Përmes dokumentave të paraqitur në tender kemi marrë përsiper plotësimin e të gjitha specifikimeve të artikujve, gjë që e rikonfirmojmë edhe një herë. Gjithashtu kemi paraqitur në tender cdo dokument që ju keni parë të arsyeshme të kerkoni, për tu siguruar për cilësinë e produkteve. Tonerat e ofertuar janë origjinale ose ekuivalente, jo të rimbushur. Tonerat janë të reja, të papërdorura, të ambalazuara në kuti. Tonerat plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë. Tonerat për printera dhe fotokopje plotësojnë sasine e faqeve sipas*

datashet-in dhe katalogut perkates te pajisjeve (printera,fotokopje) . Tonerat inkjet kane date skandence jo me pak se 1 vit nga data e Furnizimit te Mallit. Per te sqaruar: ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. Shpjegojme: Per tju konfirmuar qe kompania jone ploteson te gjitha detyrimet ligjore, po ju paraqesim nje vertetim te pageses se rregullt te detyrimeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore.

Kompania jone eshte e certifikuar sipas standarteve nderkombetare me ISO 9001 per Sistemin e Menaxhimit e Cilesise, BS PASS 99:2012 per Sistemin e Menaxhimit te Integruar, ISO 45001 per Sistemin e Menaxhimit te Sigurise ne Pune dhe ISO 14001 per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit ne vendet ku ushtrrojme aktivitetin apo ofrojme sherbimet (bashkangjitur).”

Përveç kësaj, ankimuesi në mbështetje të deklarimeve më sipër, ka paraqitur Analizë kosto prodhimi, për artikujt objekt-prokurimi, fatura tatimore shitjeje, fatura blerjeje, fletë zhdoganimi, kontrata të lidhura me autoritete kontraktore të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, oferta nga furnitore etj.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankimuesi në rastin konkret ka arritur nëpërmjet dokumentacionit provues sa më sipër, të argumentojë të gjitha elementet e ofertës së tij. Përveç argumentimit në formën e një narrative, ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet favorizuese që disponon, të tilla si eksperiencia e gjatë në treg, realizmi i një sërë kontratash me subjekte të ndryshme etj, subjekti “InfoSoft Office” SHPK ka paraqitur edhe analizën e detajuar të koston në përmbushje të gërmës a) të nenit 93 të LPP ku flitet për anën ekonomike të metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës së koston për të gjithë elementët. Në rastin konkret, gjykoj, se nga ana e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK janë dorëzuar të gjitha dokumentet provuese mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike, mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe ose ndonjë kusht favorizues, origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, duke argumentuar plotësisht se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Argumentimi i dhënë nga ofertuesi, në rastin konkret krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Gjithashtu, referuar edhe kontratatve dhe faturave të dorëzuar në SPE, konstatohet se për zërat objekt furnizimi operatori ekonomik ka dëshmuar se realizuar furnizime me sukses pa risk dështimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF- 27343-05-04-2022, me objekt: “*Blerje kanceleri dhe tonera*”, me fond limit 6.638.300 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri